



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.07/21

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si jo kontestimore e përbërë nga gjyatari Izet Gërguri, ne çështjen juridike të propozuesve S. (M.) C. P. (S.) C. nga fshati S. i E. V. ndaj kundërpropozuesve S. (M.) C. E. (S.) C. dhe F. (M.) C. të gjithë nga fshati S. i E. –V. lidhur me ndarje fizike të paluatshmërisë, pas mbajtjes se seancës kryesore, verbale e publike, me datën 08.12.2021 në të njëjtën ditë e mori këtë:

A K T V E N D I M

I.VËRTETOHET se është bërë ndarja fizike e pasurisë se paluajtshme në mes propozuesve S. (M.) C. P. (S.) C. nga fshati S. i E. V dhe kundërpropozuesve S. (M.) C. E. (S.) C. dhe F. (M.) C. të gjithë nga fshati S. i E. –V. dhe atë për pasuritë e paluajtshme që evidentohen në Çertifikatat e pronës nr.18-42/21, të datës 11.01.2021, si në vijim:

- **Propozuesit S. (M.) C.** i takojnë keto parcela: nr. 576-16, me sipërfaqe 956 m2, 1356-1 me sipërfaqe prej 2847 m2, Z.K St. i E.,- V., parcelat nr.616-1 me sipërfaqe prej 2505 m2, Z.K L.

- **Propozuesit P. (S.) C.** i takojnë keto parcela: nr.1356-3, me sipërfaqe 1665 m2, 1356-5 me sipërfaqe prej 4889 m2, Z.K S. i E.,- V., parcela nr.616-3 me sipërfaqe prej 1005 m2 Z.K L., V.

- **Kundërpropozuesit F.(M.) C.** i takojnë keto parcela: nr.1356-2, me sipërfaqe prej 2056 m2, 1356-6 me sipërfaqe prej 4869 m2, Z.K S. i E., V., parcelën nr.616-2 me sipërfaqe prej 2125 m2 dhe 27-0 me sipërfaqe prej 3049 m2 Z.K., V.

- **Kundërpropozuesit E.(S.) C.** i takon parcela: nr.1356/4, me sipërfaqe prej 952 m2.

Kundërpropozuesi S.(M.) C. nuk merrë asgjë nga pasuria e paluajtshme, objekt i ndarjes fizike.

Parcelat nr.576-15 me sipërfaqe prej 541 m2 dhe 1356-7 me sipërfaqe prej 1775 m2, mbesin rrugë private dhe pronë e përbashkët e propozuesve dhe kundërpropozuesve.

Skicat e parcelave katastrale janë pjesë përbërëse e dispozitivit të këtij aktvendimi.

II. Shpenzimet procedurale i bartin palën solidarisht.

A r s y e t i m

Propozuesit si më lart, kanë parashtruar propozim për ndarje fizike të pasurisë se paluajtshme ndaj kundërpropozuesit S. (M.) C. E. (S.) C. dhe F. (M.) C. të gjithë nga fshati S. i E. –V.

Gjykata ka caktuar seancën gjyqesore në të cilën kanë prezentuar propozuesi dhe kundërpropozuesit të cilët nuk e kanë kundërshtuar propozimin për ndarje fizike dhe as propozimin për caktimin e ekspertit gjeodet.

Gjykata ka angazhuar ekspertin gjeodet F. S. i cili ka bërë ndarjen fizike të pasurisë së paluajtshme si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pas pranimit të ekspertizës në seancë gjyqesore kanë prezentuar propozuesi dhe kundërpropozuesit të cilët bashkarisht kanë deklaruar se nuk e kundërshtojmë ekspertizën e ekspertit gjeodet Fadil Selimi të datës 06.11.2021.

Gjykata, në procedurën e provave ka lexuar Çertifikatën e Pronësisë për pasurinë e paluajtshme si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ekspertizën e ekspertit gjeodet të ekspertit F. S. të datës 06.11.2021 dhe pas shqyrtimit bashkarisht të të gjitha këtyre provave, meqenëse asgjë mes palëve nuk ishte kontestuese, konform nenit 197, 199, 201 dhe 204 të Ligjit për Procedurë Jokontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Për shpenzimet e procedurës u vendos në baze të nenit 29 të LPJK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CN.nr.07/21, datë: 08.12.2021

GJYKATËSI
Izet Gërguri

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.